

Vaughan Smith

Vaughan Smith është kameraman me honorar i cili ishte qëlluar në telefonin e tij celular ndërsa filmonte ekskluzivisht masakrën e Prekazit. Ai organizoi dhe filmoi intervistën e parë pa maskë me një anëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Fehmi Lladrovicin. Filmoi masakrën e Obrisë dhe, duke ecur fshehurazi në Kosovë nga Maqedonia, incizoi Parashutistët Britanikë duke mbërritur në Kosovë me helikopter gjatë ndërhyrjes së NATO-s. Vaughan ishte duke shkuar në aeroport me ta për t'u përballur me rusët, kur u kërkuan të ktheheshin mbrapsht nga gjenerali britanik Sir Mike Jackson.

Vaughan është pionier i lajmeve dhe themeloi Frontline Club në Londër më 2003 si ndërmarrje sociale për të mbështetur gazetarinë e pavarur dhe për të promovuar një kuptim më të mirë të lajmeve ndërkombëtare dhe mbulimit të tyre. Gjatë viteve 1990-ta, Vaughan punoi si kameraman i pavarur dhe video-gazetar i lajmeve, duke mbuluar luftërat dhe konfliktet në Irak, Afganistan, Bosnjë, Çeçeni, Kosovë dhe gjetiu. Gjatë asaj kohe themeloi dhe drejtoi Frontline News Television, agjenci e ngritur për të përfaqësuar interesat e gazetarëve të rinj që donin të zgjeronin kufijtë e profesionit të tyre. Gjatë atyre viteve të trazuara, që filluan me rënien e Komunizmit dhe zgjatën deri në sulmin e 11 shtatorit, punonjësit me honorar të Frontline kapën disa nga pamjet më të mira të konflikteve në botë.

Vaughan vetë filmoi pamjet e vetme të pakontrolluara të Luftës së Gjirit më 1991, pasi arriti të përvidhej në një njësi aktive ndërsa ishte i maskuar si oficer i Ushtrisë Britanike. Veprimet e Frontline Television News kapën imagjinatën e një brezi të tërë gazetarëve të rinj të pavarur. Kjo histori është detajuar së fundmi në librin "Frontline: Historia e Vërtetë e Rebelëve Britanikë që Ndryshuan Fytyrën e Gazetarisë në Luftë," nga David Loyn, BBC.

Gazetarët e Frontline morën mbi vete rreziqe të mëdha dhe tetë anëtarë ose ish-anëtarë janë vranë gjatë punës në terren. Frontline Club është dedikuar për kujtimin e tyre. Vetë Vaughan u qëllua dy herë por shpëtoi vetëm me lëndime të lehta. Si kameraman i pavarur, Vaughan fitoi, individualisht ose si pjesë e ekipit, 28 çmime lajmesh. Shumë prej tyre për "The Valley," film që Vaughan prodhoi për Luftën e Kosovës, i cili mbetet një nga dokumentarët më të vlerësuar të shfaqur në Channel 4 Television të Mbretërisë së Bashkuar. Gjatë kohës së Vaughan si profesionist i pavarur, ai punoi për shumë nga stacionet kryesore televizive të botës dhe u bë avokues i madh për gazetarët e pavarur që operojnë në zona të luftës.

Para se të themelonte Frontline, Vaughan ishte Kapiten në Gardën Grenadier të Ushtrisë Britanike, duke shërbyer në Irlandë të Veriut, Qipro dhe Gjermani. Ishte kapiten i ekipit të qitjes me pushkë në Ushtrinë Britanike dhe fitoi kampionatin e ushtrisë në qitje me pushkë. Vaughan është Kryetari i zgjedhur i Regjistrimit të Profesionistëve të Pavarur të Frontline, FFR, organ unik me më shumë se 1,500 persona të regjistruar i cili promovon gazetarinë e përgjegjshme dhe të sigurt dhe përfaqëson profesionistët e pavarur dhe gazetarët lokalë në mbarë botën.

Orla Guerin / Korrespondente e Lindjes së Mesme për BBC

Orla Guerin u bë korrespondente e Afrikës për BBC, me bazë në Johannesburg, në janar 2006. Para kësaj, ka raportuar nga zyra e BBC-së në Jerusalem si korrespondente e Lindjes së Mesme për pesë vjet. Ka raportuar gjerësisht për konfliktin izraelito-palestinez dhe ka mbuluar histori nga Iraku.

Orla iu bashkua BBC-së si korrespondente lajmesh në vitin 1995 dhe në janar 1996 u caktua në Bregun Perëndimor të Amerikës (me bazë në Los Angeles) ku trajtoi një sërë historish përfshirë Çmimet Oskar.

Ishte korrespondente e BBC-së për Evropën Jugore, me bazë në Romë, nga korriku 1996 deri në qershor 2000. Gjatë kësaj periudhe, ka raportuar rregullisht për konfliktin në Kosovë. Në vitin 1999 u dëbua nga kryeqyteti i Prishtinës nga forcat serbe në fillim të luftimeve. Ajo raportoi nga Maqedonia për gjendjen e refugjatëve që iknin nga kufiri. Pas rihyrjes në Kosovë, ndërsa forcat e NATO-s morën kontrollin, ajo mbuloi kthimin e mijëra refugjatëve që ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre.

Orla gjithashtu raportoi gjerësisht për konfliktin në territorin e Baskëve në Spanjën Veriore. Ka raportuar ekskluzivisht për armëpushimin e grupit separatist bask ETA në tetor 1998. Dokumentari i saj mbi ETA për programin "Correspondent" të BBC TWO ishte nominuar për një çmim Bafta.

Nga qershori deri në nëntor 2000, ka raportuar nga Moska me storie që përfshinin katastrofën e nëndetësës Kursk dhe sulmet me bombë në kryeqytetin rus.

Para se t'i bashkohej BBC-së, Orla ka punuar si prezantuese lajmesh, prezantuese dhe korrespondente e jashtme për RTE News të Irlandës. Gjatë punës me RTE ka pasur shumë udhëtime, duke mbuluar Evropën Lindore dhe Qendrore, ish-Bashkimin Sovjetik, shpërbërjen e ish-Jugosllavisë dhe rrethimin e kryeqytetit boshnjak, Sarajevës.

Është kualifikuar si gazetare në vitin 1985 me Certifikatë në Gazetari nga College of Commerce në Dublin. Diplomën Master e përfundoi në Studime Filmi nga University College Dublin.

Në vitin 2002, Orla u nderua me doktoratë nderi nga University of Essex dhe fitoi çmimin Gazetarja e Vitit nga London Press Club. Në vitin 2003, ajo mori çmimin për Lajme dhe Faktenga Gratë në Film dhe Televizion MB. Në vitin 2004, u nderua me titullin MBE për shërbimin e saj në transmetim.

Jeremy Bowen

Që nga marsi i vitit 2003, Jeremy Bowen ka qenë korrespondent special për Lajmet e Televizionit BBC. Më parë ishte bashkë-prezantues në programin e mëngjesit të BBC One për dy vjet pas lansimit në tetor 2000.

Jeremy iu bashkua BBC-së në vitin 1984 si praktikant lajmesh. Ka pasur periudha në Redaksinë e Lajmeve të Radios dhe si korrespondent i Lajmeve të Televizionit para se të bëhej korrespondent në Gjenevë për Lajmet e Radios në vitin 1987.

Si korrespondent me përvojë lufte, ka raportuar nga më shumë se 70 vende, duke mbuluar konfliktet në Gjirin Persik, El Salvador, Liban, Bregun Perëndimor, Afganistan, Kroaci, Bosnje, Çeçeni, Somali dhe Ruanda.

Jeremy u bë korrespondent për Lindjen e Mesme në vitin 1995 dhe fitoi çmimin Korrespondenti më i Mirë i Lajmeve në Festivalin e Televizionit të Nju Jorkut. Këtë sukses e përsëriti vitin e ardhshëm, kur fitoi çmimin për raportimin më të mirë për Breaking News për mbulimin e vrasjes së Kryeministrit Yitzhak Rabin.

Gjatë krizës së Kosovës të vitit 1999, ka raportuar gjerësisht nga rajoni, shpeshherë në kushte të rrezikshme, të cilat përfshinë grabitjen me armë nga banditët ndërsa raportonte nga kufiri shqiptar.

Në gusht të vitit 1999, prezantoi një program special që shqyrtonte pasojat e tërmetit në Turqi.

I lindur në Cardiff në vitin 1960, Jeremy u arsimua në Shkollën e Lartë të Cardiff. Vioi University College London dhe më pas shkoi në Universitetin John Hopkins në Itali dhe SHBA.

Matthew Price / Korrespondent i Lindjes së Mesme për BBC

Matthew Price ka qenë korrespondent i Lindjes së Mesme për BBC me bazë në Jerusalem që nga marsi 2004. Para kësaj, ishte korrespondent i BBC-së në Beograd nga viti 2002 dhe mbuloi ngjarjet në të gjithë ish-Jugosllavinë dhe Shqipërinë.

Matthew iu bashkua BBC-së në vitin 1994 si gazetar praktikant për radio lokale. Vazhdoi të punojë si gazetar për BBC Radio Lincolnshire midis viteve 1995 dhe 1997 dhe për BBC Newcastle nga 1997 deri në 1999, ku mbuloi lajmet televizive dhe ato radiofonike.

Në vitin 1999, u bashkua me Newsround, programin kryesor të BBC-së për çështjet aktuale për fëmijë. Ka pranuar një numër çmimesh për punën e tij. Në vitin 2000 u votua si Gazetari i Ri i Vitit nga Shoqata Mbretërore e Televizionit.

Dy vjet më vonë, në vitin 2002, së bashku me producenten Audrey Neil dhe kameramanin Mark McCauley, fitoi çmimin Bafta për punën e tij në Afganistan pas rënies së Talebanëve nga pushteti.

Gjatë vitit 2003, raportoi nga Gjiri dhe Bagdadi gjatë dhe pas luftës në Irak. Në mars të vitit 2004, u bë korrespondent i Lindjes së Mesme për BBC, duke punuar për të gjitha kanalet e BBC-së, për televizion, radio dhe online.

I lindur në Londër në qershor të vitit 1972, Matthew u diplomua nga Universiteti i Kembrixhit në vitin 1994 me diplomë në Gjeografi.

Fergal Keane / Korrespondent special i BBC

Fergal Keane është korrespondent special për BBC News, me bazë në Londër në njësinë e Çështjeve Botërore të BBC-së. Fergal Keane iu bashkua BBC-së në vitin 1989 si korrespondent për Irlandën Veriore.

Në gusht 1990, u caktua korrespondent për Afrikën e Jugut, pasi kishte mbuluar rajonin gjatë fillimit të viteve 1980. Nga viti 1990 deri në 1994, raportimet e Fergal përfshinin trazirat në qytetet e Afrikës së Jugut dhe zgjedhjet e para shumë-racore pas përfundimit të aparteidit dhe gjenocidit në Ruanda.

Në vitin 1995 u caktua si korrespondent për Azinë me bazë në Hong Kong dhe dy vjet më vonë u kthye për tu vendosur në Njësinë e Çështjeve Botërore të BBC-së në Londër. Fergal u kthye në Ruanda në vitin 2004, për një program special të BBC Panorama që shënoi 10-vjetorin e gjenocidit.

Është shpallur fitues i përgjithshëm i Çmimit të Shtypit të Amnesty International në vitin 1993 dhe ka fituar çmimin Amnesty për televizion në vitin 1994 për hulumtimin e tij të gjenocidit në Ruanda, "Journey Into Darkness".

Karrierën e tij në gazetari e filloi në vitin 1979 si gazetar për Limerick Leader dhe Chronicle para se të kalonte në gazetën e përditshme kombëtare, The Irish Press. Në vitin 1996, Fergal Keane u nderua me titullin OBE për shërbimin e tij në gazetari.

Paul Wood / Korrespondent i mbrojtjes për BBC

Paul Wood u emërua korrespondent i mbrojtjes për BBC në maj 2005. Më parë ishte korrespondent i BBC-së për Lindjen e Mesme duke mbuluar botën arabe. Ka qenë në Bagdad gjatë pushtimit të Irakut në vitin 2003 dhe në Falluxha gjatë betejës për qytetin.

Në vitin 2004, mbulimi i tij për Irakun fitoi çmimin televiziv Bayeux për korrespondentët e luftës dhe "Golden Nymph" në festivalin televiziv të Monte Carlos. Këto çmime iu dhanë për raportimin e tij për sulmin vetëvrasës shkatërrues mbi pelegrinët irakianë në Karbala. Paul vazhdoi transmetimin ndërsa disa bomba shpërthyen rreth tij dhe ekipit të BBC-së.

Së fundi ishte i dyti në çmimet e Shoqatës Mbretërore të Televizionit për raportimin më të mirë ndërkombëtar në vitin 2005, për mbulimin e tij të Falluxhës.

Më parë ishte korrespondenti i BBC-së në Beograd dhe korrespondenti i Ballkanit, duke raportuar prapa linjave serbe ndërsa udhëtonte me guerilët kosovarë gjatë bombardimeve të NATO-s në qershor 1999. Gjithashtu ka raportuar nga Kroacia, Bosnja, Maqedonia, Çeçenia, Algjeria, Libia, Arabia Saudite, Siria dhe Sudani, përfshirë Darfurin.

Më parë ka qenë korrespondent për BBC-në në Irlandë Veriore dhe producent në redaksinë e Shërbimit Botëror në Bush House. Para se t'i bashkohej BBC-së, ka punuar për gazeta lokale dhe kombëtare. Ka diplomuar në LSE në Shkenca Politike.

Kate Aide / BBC, Prezantuese e "From Our Own Correspondent"

Kate Adie, autore dhe prezantuese, u bë figurë e njohur për shikuesit përmes punës së saj si Korrespondente Kryesore e Lajmeve të BBC-së. Ajo konsiderohet ndër raportueset më të mira, si dhe një nga gratë e para britanike që dërgonte raportime nga zonat e rrezikshme anembanë botës. Është gjithashtu e njohur si prezantuese e "From Our Own Correspondent" në Radio 4 dhe si e ftuar në shumë programe të tjera radiofonike dhe televizive.

Kate është emëruar "Raportuesja e Vitit" dy herë nga Shoqata Mbretërore e Televizionit; herën e parë për mbulimin e saj të përfundimit të rrethimit të Ambasadës Iraniane nga SAS në vitin 1980. Ka fituar çmimin e Monte Carlo International Golden Nymph në vitet 1981 dhe 1990 dhe u nderua me titullin OBE në vitin 1993.

Kate është rritur në Sunderland dhe ka studimet e para i përfundoi nga Universiteti i Newcastle ku studioi gjuhën suedeze. Ishte anëtare e Teatrit Kombëtar të Rinisë dhe ende ndjek teatrin dhe viziton galeritë kur ka kohë. Është një lexuese e zellshme e letërsisë dhe historisë dhe ka shërbyer si gjyqtare e çmimeve letrare, përfshirë çmimin Orange për Letërsi, çmimin e vjetër Whitbread dhe Costa. Kate gjithashtu ka shërbyer si anëtare bordi në Muzeun Imperial të Luftës dhe libri i saj "Corsets to Camouflage", histori e shoqëruar me ekspozitën e muzeut për gratë në uniformë, u botua nga Hodder & Stoughton për të përkuar me hapjen e ekspozitës në vjeshtën e vitit 2003.

Libri i saj i parë, "The Kindness of Strangers", përshkrim i punës së saj si raportuese dhe si e mori atë, u botua nga Headline në vitin 2002 dhe qëndroi në listën e librave më të shitur të Sunday Times për 37 javë. Hodder & Stoughton tani ka botuar "Nobody's Child: The Lives of Abandoned Children" (2005) që formoi bazën e serive dokumentare të BBC 1, "FOUND", dhe së fundmi, "INTO DANGER" (2008), një studim mbi burrat dhe gratë që rrezikojnë jetën e tyre për punë.

Ben Brown

Ben Brown iu bashkua “BBC TV News” në vitin 1988 dhe ishte Korrespondent për Çështjet e Jashtme deri në vitin 1991, ku raportoi për rënien e Murit të Berlinit dhe Luftën e Gjirit, nga Arabia Saudite dhe Kuvajti. U emërua Korrespondent në Moskë në vitin 1991, ku ishte dëshmitar i rënies së fundit të Komunizmit dhe rënies së Mikhail Gorbachev.

Në vitin 1993 dhe vitin pasues ishte në Çeçeni për fillimin e luftës civile. Ky raportim i këtij konflikti i solli disa çmime ndërkombëtare, duke përfshirë Çmimin e Korrespondentit të Luftës të Vitit në Bayeux dhe Çmimin Golden Nymph nga Festivali i Televizionit në Monte-Karlo.

Në janar të vitit 1995, Brown rifilloi rolin e tij lëvizës si korrespondent i jashtëm, me bazë në Londër. Ai mbuloi shpërbërjen e Jugosllavisë, duke raportuar nga Bosnja-Hercegovina, Kroacia dhe Kosova, ku tregimet e tij ndihmuan në sigurimin e disa çmimeve për BBC-në, përfshirë një çmim BAFTA (British Academy of Film and Television Arts). “Reporting House” është duke shfaqur 30 raportime të tij gjatë udhëtimeve në Kosovë në periudhën 1998-2000.

Për të prodhuar këto raportime televizive, Ben dhe Vaughan punuan me përkthyes dhe prodhues lokalë si Fisnik Abrashi, Belma Bajrami, Safet Gashi, Visar Kryeziu dhe Jeta Xharra.

Ben Brown

David Loyn është autor, gazetar dhe analist i specializuar për Afganistanin, Azinë Jugore dhe historinë perandorake. Është anëtar i panelit këshillues për FCDO-në për politikën në Azinë Jugore dhe bashkë-drejtuës i një kursi të karrierës së mesme për diplomatë për Akademinë Ndërkombëtare të FCDO-së për Azinë Jugore dhe Afganistanin.

Është ligjërues vizitor në Departamentin e Studimeve të Luftës në King’s College, Londër dhe shkruan rregullisht për Afganistanin për “Spectator”.

Si korrespondent i BBC-së për më shumë se tri dekada, David ka fituar çmime në raportim për radio e televizion, duke përfshirë çmimin Gazetari i Vitit nga Shoqata Mbretërore e Televizionit, për raportimin e tij mbi konfliktin në Kosovë në vitin 1998. Libri i tij “Frontline” u përzgjedh për Çmimin Orwell. Postimi i tij i fundit në BBC ishte si korrespondent në Afganistan, vend që e ka vizituar që nga viti 1994, duke përfshirë disa udhëtime gjatë kohës së kontrollit nga Talibanët.

Në periudhën 2017-2018, David punoi si këshilltar për Komunikimet Strategjike në zyrën e Presidentit afgan Ashraf Ghani. Ka diplomë Master në Histori Moderne nga Universiteti i Oksfordit dhe është avokat i kualifikuar.

David është anëtar bordi i Peace Direct dhe Anëtar i Asociuar i Muzeut Perandorak të Luftës.

Për prodhimin e këtyre raportimeve televizive, David dhe Vaughan punuan me përkthyes dhe prodhues lokalë, si Fisnik Abrashi, Belma Bajrami, Safet Gashi, Visar Kryeziu dhe Jeta Xharra

Donika Shahini Lami

Donika Shahini Lami është gazetare e njohur, psikologe klinike dhe aktiviste, themeluese dhe drejtore e Qendrës së Mirëqenies Psikologjike “ORA”, e cila ofron shërbime këshillimi, psikoterapie dhe trajtimi për çështje të ndryshme psiko-sociale, përfshirë stresin post-traumatik dhe dhunën në familje.

Nga viti 1997 deri në vitin 2003 ishte gazetare për revistën “KOMBI” dhe njëkohësisht gazetare dhe koordinatore për televizionin publik japonez NHK. MEDIA VISION PRODUCTION” - Romë, Itali. Ishte gazetare dhe koordinatore e ekipit filmik për gjashtë dokumentarë për luftën në Kosovë, duke mbuluar të gjitha zonat e luftës. Është gazetarja e parë televizive që raportoi nga Prekazi/Drenica pas masakrës së familjes Jashari më 5-6 mars 1999. Gjithashtu ka qenë gazetare/raportuese nga zonat e tjera të luftës.

Ilaz Bylykbashi ¹

Ilaz Bylykbashi, i lindur më 16 maj 1955, në Baicë, Lipjan, që herët zhvilloi interesim për fotografimin, sa ishte në shkollë të mesme në Gjilan. Studimet i vijoi për gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë, por pati ndërprerje për arsye personale. Duke qenë në nevojë për punësim gjatë studimeve, Bylykbashi filloi të punojë si gazetar i krimeve për gazetën studentore "Bota e Re." Karrierën gradualisht e zhvendosi në fotografi kur zëvendësoi kolegët fotografë që mungonin.

Në korrik të vitit 1982, Bylykbashi filloi punën si fotogazetar për "Rilindja," ku arriti të kapë ngjarjet e rëndësishme historike në Kosovë nga vitet e 1970-ta deri në të 90-at. Me punën e tij dokumentoi momentet kyçe, duke përfshirë masakrën e Jasharëve dhe 58 të tjerë në Prekaz. Është përballë me keqtrajtim të dhunshëm nga autoritetet serbe gjatë viteve të 1990-ta dhe është njohur për fotografimin e incidenteve kritike, si largimi i shenjës "Rilindja" dhe zëvendësimin e saj me mbishkrimin "Graçanica" në ciriliken serbe pas revokimit të autonomisë së Kosovës nga Slllobodan Milloshëviq më 1989.

Hazir Reka ³

I lindur në vitin 1961 në Ferizaj, jeton dhe punon si në Ferizaj ashtu dhe në Prishtinë. Punën si fotograf profesionist e filloi në vitin 1984 për revistën Bota e Re. Fotografitë e tij janë publikuar në revista kryesore të ish-Jugosllavisë (Mladina, Delo, Oslobođenje, Vreme, Start) si dhe në disa nga revistat më prestigjioze në botë (New York Times, Herald Tribune, Liberation, Time, Washington Post, Wall Street Journal). Në vitin 1998 filloi të punojë për agjencinë e lajmeve Reuters, ku ka mbuluar protestat dhe luftën në Kosovë, si dhe hyrjen e NATO-s në Kosovë. Reka gjithashtu kaloi kohë duke raportuar për luftën në Irak. Veprat e tij janë shfaqur në ekspozita personale në Zagreb, Gjenevë (Zvicër), Nevers (Francë), me Jean-François Baptiste, në Arabi Saudite dhe Barcelonë. Në Kosovë ka organizuar ekspozitë në vitin 2014 në Galerinë Kombëtare të Kosovës. Në vitin 1991 publikoi vëllimin e fotografive "Ecje në Errësirë - Kosova 1988-1990".

informatat për karrierën janë gjetur dhe përshkruar nga:

¹ <https://www.kultplus.com/intervista/ilaz-bylykbashi-shkrepjet-e-te-cilit-u-bene-rufeja-qe-goditi-boten-me-te-verteten-e-kosoves-nen-okupimin-serb/>
<https://balkaninsight.com/2024/04/19/witness-to-violence-photojournalist-recalls-decades-of-documenting-kosovos-turbulent-times/>

² <https://balkaninsight.com/2024/06/07/framing-suffering-kosovo-war-photographer-opens-his-archives/>

³ <https://imagomundicollection.org/artworks/hazir-reka-exit-light-2/>

⁴ info provided by the artist

Besnik Mehmeti ²

Besnik Mehmeti, fotograf shqiptar nga Maqedonia e Veriut, hyri në Kosovë në qershor të vitit 1999 bashkë me trupat e NATO-s, duke dokumentuar shkatërrimin dhe pasojat e luftës, duke përfshirë skenat e trupave të djegur brenda shtëpive në rajonin e Prishtinës. Tani ai ka selinë në Londër, si video-redaktor në Al Jazeera.

Mehmeti filloi karrierën e tij duke dokumentuar jetën e komunitetit etnik shqiptar në Maqedoninë e Veriut në vitin 1995, si dhe protestat e shqiptarëve në Londër pas trazirave në Kosovë. Ai u kthye në rajon në vitin 1998, gjatë luftës në Kosovë, si dhe mbuloi bombardimet e NATO-s nga marsi deri në qershor 1999. Gjatë kësaj periudhe, ai ka dokumentuar edhe krizën e refugjatëve, duke kapur momentet e vështira të cilat u ballafaquan nga shqiptarët e zhvendosur të Kosovës.

Pasi kishte ruajtur fotografitë e tij të luftës për 25 vjet, Mehmeti tani tashmë është gati të ndajë punën e tij dhe po planifikon të botojë një libër me fotografitë e tij që dokumentojnë luftën e Kosovës.

Eliza Hoxha ⁴

Eliza është arkitekte me profesion, por publiku atë e njeh edhe përmes shumë angazhimeve të tjera në muzikë, fotografi, shkrime, art e politikë.

Mbi të gjitha ajo është një aktiviste urbane në luftë e në paqe.

Gjatë viteve të '90-ta ajo ishte e angazhar në Javoren Politike "Zëri" si bashkëpunëtoresh e jashtme e fotografisë. Pas luftës fotografinë e bënte vetëm për angazhimet e veta dhe bashkë me muzikën dhe format e tjera të shprehjes artistike ajo e zgjeron gamën e komunikimit të saj me publikun. Kujtojmë këtu projektet e saj të angazhuara për të zhdukurit nga lufta në Kosovë, për viktimat e dhunës seksuale, sistemin paralel të viteve të 90-ta, etj. I gjitha angazhimi i saj artistik është aktivizëm artistik. Përtej më shumë se 25 ekspozita personale ajo ishte pjesë edhe e shumë ekspozitave kolektive brenda dhe jashtë Kosovës.

Në vitin 2018 përfaqësoi Kosovën në Bienalen e Venecias për Arkitekturë me projektin "Qyteti është kudo". Është autore e librit "Qytei dhe Dashuria" dhe editore e librit "Qyteti është kudo"

Përtej ekspozitave vetanake, ajo ka kuruar një sërë ekspozitash, disa me theks të vecantë mbi artin dhe aktivizmin e grave në Kosovë.

Nga viti 2003 punon në Fakultetin e Arkitekturës/ Departamenti I Urbanizmi Aktualist është edhe deputete e Kuvendit të Kosovës.

Thomas Dworzak ⁵

Tomas Dworzak, lindur në Gjermani më 1972, është fotograf i shquar që ka mbuluar ngjarje e lajme të mëdha që nga vitet 1990. Ai filloi të udhëtonte e të fotografonte konfliktet që në moshën 16-vjeçare, duke përfshirë ato në Irlandën Veriore, Izrael/Palestinë, si dhe në Jugosllavi. Dworzak ndoqi studimet për fotografi e gjuhë në Spanjë, në Republikën Çeke, si dhe Rusi. Ai kaloi vitet e 90-ta në Gjeorgji, duke botuar librin "Kavkaz" më 2010.

Veprat e tij të njohura janë "Taliban" (2003), "M*A*S*H IRAQ" (2007), si dhe "Feldpost" (2013–18), ku dokumentohen kujtimet e Luftës së Parë me anë të 1,568 kartolinave. Dworzak ka fotografuar revolucionet në republikat ish-sovjetike, si dhe ka mbuluar ndodhi në shumë vende. Ai është edhe kurator, duke hulumtuar kulturën digjitale përmes memeve (memes) në Instagram.

Gjatë krizës së refugjatëve më 2015, ai krijoi dhe shpërndau Guidën fotografike "Europe – a photographic guide for refugees." Projekti i tij "War Games" (Lojëra lufte) zhvendosi vëmendjen tek bota virtuale në "Zoom" gjatë pandemisë Covid-19. Më 2021, ai botoi "Khidi – The Bridge" (Ura Khidi), skenar/libër fotografik për trupat gjeorgjiane. Dworzaku iu bashkëngjiti shtëpisë Magnum Photos më 2000, u bë anëtar i plotë më 2004, si dhe shërbeu si President i saj nga viti 2017 deri më 2020.

Paul S. Refsdal ⁷

Paul Refsdal u lind në Kongsvinger, Norvegji. Ai u diplomua në Shkollën e Oficerëve të Ushtrisë Norvegjeze në vitin 1983, në moshën 19-vjeçare.

Refsdal raportoi për konflikte të ndryshme gjatë viteve 1980, duke përfshirë luftën sovjeto-afgane, ku u takua me shkrimtarin britanik Jason Elliot, si dhe punoi me separatistët tamilë. Ai gjithashtu mbuloi grupet guerile në Amerikën Latine, duke përfshirë Unitetin Kombëtar Revolucionar të Guatemalës dhe Rrugën e Ndrishme (Shining Path) në Peru. Më 1999, ai bashkëpunoi me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, gjatë së cilës u lëndua, e më pas u shpëtua, me ndihmën e ministrit të jashtëm të Norvegjisë.

Në vitin 2009, Refsdal fitoi financimin për prodhimin e një dokumentari për talebanët. Ndërsa mblidhte materiale në Afganistan, ai u rrëmbye dhe u mbajt për haraç. Ai u konvertua në Islam gjatë mbajtjes së tij, si dhe u lirua më 12 nëntor 2009, pas negociatave me Ministrinë e Jashtme Norvegjeze. Dokumentari "Fanget av Taliban" u publikua në vitin 2010, pasuar nga versioni ndërkombëtar, "Taliban: Prapa maskave", transmetuar në CNN. Refsdal u nominua për çmimin Rory Peck, si dhe kontribuoi në një seri që fitoi Çmimin National Headliner. Edhe libri i tij "Geriljareporterren" u botua në vitin 2010.

Në verën e vitit 2013, Refsdal kaloi gjashtë javë me luftëtarët rebelë myslimanë në Siri gjatë luftës civile, duke i përshkruar ata si dashamirës, por ushtarakisht amatorë.

Alan Chin ⁶

Alan Çin është fotograf, profesor dhe shkrimtar amerikan, i cili ka punuar si fotoreporter i pavarur në pika të ndryshme të botës, që nga viti 1996, duke përfshirë Kinën, Jugosllavinë, Afganistanin, Irakun, Azinë Qendrore, Egjiptin dhe Tunizinë. Në SHBA, ai ka dokumentuar rrugëtimin e Lëvizjes për të Drejtat Civile, pasojat e uraganit Katrina dhe zgjedhjet presidenciale të vitit 2008. Karriera e tij filloi me fotografimin e intervenimit në sheshin Tiananmen më 1989.

Çin kontribuon në Newsweek dhe The New York Times, punon si redaktor dhe fotograf në BagNews, si dhe shërben si Drejtor Menaxhues i Projektit Përballja me Ndryshimin: Dokumentimi i Amerikës (FCDA). Ai gjithashtu ligjëron për foto-gazetari në Universitetin e Kolumbisë. Aktualisht është duke punuar në një libër për Taishan, rajonin e tij stërgjyshor, si dhe është një partner themelues i Shtëpisë Red Hook Editions.

Puna e Çinit në Kosovë i solli nominimet për çmimin Pulitzer në vitet 1999 dhe 2000, ndërsa fitoi Sfidën e Arteve të Detroitit të Fondacionit Knight 2017. Fotografia e tij është pjesë e koleksioneve të Muzeut të Artit Modern dhe Institutit të Arteve të Detroitit. Ai ka lindur dhe është rritur në lagjen kineze të Nju Jorkut.

informatat për karrierën janë gjetur dhe përshkruar nga

⁵ <https://www.magnumphotos.com/photographer/thomas-dworzak/>

⁶ [https://en.wikipedia.org/wiki/Alan_Chin_\(photographer\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Alan_Chin_(photographer))

⁷ https://en.wikipedia.org/wiki/P%C3%A5l_Refsdal

Andrew Testa ⁸

Në një karrierë të shtrirë për më shumë se tridhjetë vjet, Endru Testa ka punuar gjerësisht në MB, Ballkan dhe Lindjen e Mesme, duke fotografuar çështje rreth konfliktit, të drejtave të njeriut dhe mjedisit. Andrew ka lindur në Londër, Angli në 1965. Ai e filloi karrierën e tij fotografike në fillim të viteve 1990, duke punuar si i pavarur për gazetat Guardian dhe Observer. Gjatë gjithë dekadës, ai dokumentoi lëvizjet në rritje të Protestave Mjedisore dhe të Drejtave të Kafshëve në MB. Në vitin 1999, ai riorientoi vëmendjen e tij drejt Ballkanit, duke mbuluar luftën në Kosovë. Në fund të vitit 1999, u transferua në Kosovë, të cilën e përdori si bazë për të mbuluar ngjarjet në Evropën Lindore, Azinë Qendrore dhe Lindjen e Mesme. Në vitin 2005 u transferua në Nju Jork, ku qëndroi për pesë vjet. Ai tani jeton në Londër, me gruan dhe dy fëmijët e tij. Vitet e fundit, ai e ka përqendruar vëmendjen e tij në trazirat politike të shkaktuara nga Brexit-i dhe pasojat afatgjata të tij për Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën.

Ai është bashkëpunëtor i rregullt i New York Times, ndërsa puna e tij është botuar gjerësisht në revista si Newsweek, Time, Stern, Geo, Paris Match, Der Spiegel, The Sunday Times Magazine, The Independent Magazine, Mother Jones, Mare dhe Granta.

Paul Lowe ⁹

Paul Lou është fotograf i vlerësuar me çmime, puna e të cilit është paraqitur në botime të njohura si Time, Newsweek, Life, The Sunday Times Magazine, The Observer, The Independent dhe The Telegraph. Ai ka mbuluar ngjarje të rëndësishme globale, si rënia e Murit të Berlinit, lirimi i Nelson Mandelës, uria në Afrikë, konflikti jugosllav dhe shkatërrimi i qytetit të Groznit. Duhet theksuar që fotot e tij nga prilli 1999, të bëra në kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe Shqipëri, u botuan në revistën Telegraph, The New York Times dhe një revistë franceze.

Paul është po ashtu Shef Katedre për programin Master në Fotogazetari dhe Fotografi Dokumentare në Kolegjin e Komunikimit në Londër, Universiteti i Arteve në Londër. Ai luajti rol kyç në avancimin e programit drejt titullit të plotë Master në vitin 2004. Përveç kësaj, ai ka shkruar disa libra, duke përfshirë "Boshnjakët", i cili dokumenton luftën dhe situatën e pasluftës në Bosnje, dhe ka qenë bashkautor i librit "Të Kuptojmë Fotogazetarinë". Hulumtimi i tij fokusohet kryesisht në fotografimin e konflikteve, duke kontribuar në libra si "Përshkrimi i mizorive: Fotografia në krizë" dhe "Fotografia dhe konflikti".

Sei Motoda ¹⁰

Jam i lindur në Himeji, Japoni, në vitin 1953. Në vitin 1978 fillova të punoj si reporter i lajmeve për Nippon Television (NTV) në Tokio. Fillimisht mbuloja lajmet vendore si politika. Pastaj në vitin 1989 historia botërore ndryshoi: Muri i Berlinit ra dhe Bush dhe Gorbaçov u takuan në Maltë për ta shpallur fundin e Luftës së Ftohtë. Unë shkova në Maltë si anëtar i ekipit të lajmeve dhe u emocionova nga ndryshimi dramatik i historisë. I kërkova shefit tim të më dërgonte në Evropë dhe në vitin 1994 më caktuan si shef të zyrës në Londër. Në atë kohë gadishulli Ballkanik ishte në trazira. Vizitova Bosnjën, Shqipërinë dhe Kosovën për t'i mbuluar konfliktet. U befasova të shoh se luftërat e nxehta shpërthenin edhe në Evropën e shekullit 20. E bëra raportin për Kosovën në verën e vitit 1998 dhe shumë pak japonezë dinin diçka për Kosovën atëherë. Raporti për Kosovën ishte raporti im i fundit nga Evropa pasi më kthyen përsëri në Tokio në gusht. U bëra redaktor i lajmeve të huaja në vitin 2001. Në vitin 2014 u largova nga NTV dhe ligjërova gazetarinë në Universitetin Hakuoh në Tochigi, Japoni, deri në mars 2024.

informatat për karrierën janë gjetur dhe përshkruar nga

⁸ <https://www.andrewtesta.co.uk/profile>

⁹ <https://theviiifoundation.org/profile/paul-lowe/>
<https://www.panos.co.uk/photographer/paul-lowe>

¹⁰ *Biography provided by the journalist*

Max Stahl / Christopher Wenner

Ky prodhues britanik i dokumentarëvei pavarur dhe i guximshëm nisi karrierën e tij si Christopher Wenner, një aktor dhe regjisor teatri dhe pastaj bashkë-prezantues i programit kryesor për fëmijë të BBC-së, 'Blue Peter', në fund të viteve 1970. Në vitet 1980 ai filloi të udhëtonte në zona konflikti, Amerikë Qendrore, Liban dhe të tjera, për të bërë dokumentarë.

Nga vitet 1990 ai adoptoi pseudonimin Max Stahl si një masë që ia mundësoi të vazhdojë të futet në vende të rrezikshme, veçanërisht në Timor-Leste (Timori Lindor), ku ai bëri emër duke filmuar një masakër nga trupat indoneziane në vitin 1991. Ajo dhe kontributi i tij i mëvonshëm në dokumentarin 'Vdekja e një Kombi' ishin kontribute të mëdha për kauzën e Timorit Lindor. Puna e tij në vitet 1990 e çoi gjithashtu në Rusi, Çeçeni dhe Ballkan.

Ai jetoi vitet e tij të fundit në Timor-Leste të pavarur, duke themeluar Qendrën Audiovizuale 'Max Stahl' për Timor-Leste, duke grumbulluar një arkiv prej mbi 5000 orë xhirimesh gjatë dekadave të luftës për pavarësi. Ai vdiq nga kanceri i fytit në vitin 2021.

Max (Chris) erdhi në Kosovë në vjeshtën e vitit 1997, për të bërë raporte dokumentare për 'UK Channel 4 News' dhe si vëzhgues i pavarur i zgjedhjeve serbe në atëherë provincën. Raportimi i tij i parë kishte të bëjë për ato zgjedhje. Alex Anderson, vëzhguesi afatgjatë i misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE-së me seli në Prishtinë në atë kohë, kujton: "Chris kishte një stil si të Indiana Jones, madje e kishte edhe kapelën".

Max vazhdoi vizitat e tij në Kosovë deri në pranverën e vitit 1998, duke bërë raporte që dokumentuan këtë periudhë kur konflikti po ziente e po fillonte të shpërthente, para se të tërhiqte vëmendjen e mediave botërore. Më 9 mars 1998 ai po filmonte një demonstratë masive në Prishtinë, për ta protestuar dhunën ushtarake serbe në Drenicë, kur tre burra serbë të armatosur dhe me xhaketa lëkure e kapën, e tërhoqën përmes një dere, e grabitën dhe e rrahën. Përshkrimi i tij se çka ndodhi mund të shihet këtu:

<https://www.youtube.com/watch?v=BSMgsQjvOws>

EMIR SULJAGIĆ

Dr. Emir Suljagić është gazetar, autor, profesor dhe drejtor i Qendrës Memoriale Srebrenica-Potoçari që nga viti 2019.

Suljagić ka doktoraturë në Shkenca Politike nga Universiteti i Hamburgut. Ka shërbyer si Ministër i Arsimit në kantonin e Sarajevës nga 13 janar 2011 deri më 29 shkurt 2012 si dhe ka qenë zëvendësministër i Mbrojtjes nga 31 mars 2015 deri më 10 dhjetor 2015.

Ka punuar si përkthyes i gjuhës angleze për organizatën e Kombeve të Bashkuara në Srebrenicë dhe ka filluar karrierën e tij si gazetar duke punuar për revistën javore, fituese të çmimeve të ndryshme, Dani. Suljagić ka punuar si korrespondent i Institutit për Raportim të Luftës dhe Paqes, duke raportuar nga Gjykata Ndërkombëtare për Krime në ish-Jugosllavinë (ICTY). Mes tjerash, ka botuar për revistat New York Times, Boston Globe, AlJazeera, El Pais, Die Zeit dhe Oslobodjenje. Suljagić ka ligjeruar lëndën Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin Ndërkombëtar të Sarajevës. Publikimi përkujtimor i tij "Kartolina nga Varri" (2003) paraqet rrëfimin e parë të një të mbijetuarit të Srebrenicës të botuar në anglisht dhe më pas të botuar në tetë gjuhë të tjera.

Marija Ristic

Marija Ristic është një gazetare hulumtuese me përvojë dhjetëvjeçare në raportimin e krimeve të luftës, hulumtimet me burime të hapura dhe teknologjitë e reja.

Aktualisht, ajo është menaxhere në 'Amnesty International Crisis Evidence Lab', ku drejton 'Digital Verification Corps' – një rrjet që mbështet ekipet e 'Amnesty International' në dokumentimin dhe gjetjen e fakteve për të drejtat e njeriut. 'Evidence Lab' bashkon hetues, inxhinierë, zhvillues dhe të tjerë për të pilotuar mjete të reja, si intelijenca artificiale, detektimi nga distanca, identifikimi i armëve dhe analiza e të dhënave të mëdha.

Para se t'i bashkohej 'Amnesty', Marija ishte drejtoreshë ekzekutive e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese, një organizatë mediatike jo-fitimprurëse në Evropën Juglindore dhe Qendrore.

Për punën e saj si gazetare, ajo ka fituar shumë çmime, duke përfshirë çmimin vjetor të Lirisë së Shtypit nga Reporterët pa Kufij. Marija Ristic ka prodhuar shumë dokumentarë dhe raporte mbi krimet e supozuara të luftës në Kosovë, përfshirë dokumentarin "Të Pidentifikuarit" dhe ka krijuar bazat e të dhënave për varret masive nga luftërat në ish-Jugosllavi. Ajo diplomoi nga Akademia e Gjenevës për të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare dhe mbajti pozicione bursisti në Universitetin "Columbia" në Nju Jork dhe Universitetin "Free" të Berlinit.

DENIS DŽIDIĆ

Denis Džidić është drejtor ekzekutiv dhe redaktor për BIRN Bosnjë dhe Hercegovinë (në portalin 'Detektor') që nga viti 2019. Karrierën e tij gazetareske e ka filluar në gazetën ditore Oslobodjenje në vitin 2006.

Në BIRN Bosnjë dhe Hercegovinë hyri në vitin 2008. Shumicën e karrierës së tij ia ka përkushtuar çështjes së drejtësisë kalimtare dhe raportimit të krimeve të luftës në luftën e Bosnjës në vitet 1992-1995. Ka raportuar edhe nga Haga. Džidić ka punuar në "Institutin për Raportim të Luftës dhe Paqes" në Sarajevë dhe në Hagë. Është fitues i disa çmimeve, ndër të tjera nga Shoqata "Biti Novinar" për kronika të vazhdueshme dhe kontribut të çmuar në zbulimin e së vërtetës rreth gjenocidit në Srebrenicë.

Nën udhëheqjen e tij, në vitin 2020, Detektori (program i BIRN Bosnje e hercegovinë) fitoi Çmimin Evropian për Shtyp për raportimet lidhur me gjykimet e krimeve të luftës, çështjeve të drejtësisë kalimtare dhe problemeve me të cilat janë përballur viktimat e luftës së viteve 90-ta. Aktualisht është anëtar i Komitetit Përgatitor të Çmimit Evropian për Shtyp. Është i diplomuar në Departamentin e Gazetarisë së Fakultetit të Shkencave Politike në Sarajevë dhe ka titull Magjistrate në drejtësi ndërkombëtare.